

Artizanati

Është pjesë e ekzistencës dhe jetesës, ruajtur dhe mbartur brez pas brezi nga banoret e ketyre trevave, që nga lashtesia e deri në ditët tona. Zhanre te ndryshme të muzikës, këngëve, elegjive, valleve, interpretuar nga mbartesit e tyre, si dhe ngjyrat e mrekullueshme të kostumografisë së kësaj trevave, janë vlera te rëndesishme të kulturës sonë kombëtare të trashëguara ndër vite nga banorët e këtushëm.

Këtu dallojmë një trashëgimi të pasur etno-kulturore të pothuajse të gjitha viseve të Shqipërisë së Epërme, kushtëzuar edhe nga migracionet e shumta që ka patur në këtë trevë, si dhe ruajtja e vlerave prej nga kanë ardhur bartësit.

Artizanët, sidomos ata të Zadimës, po vazhdojnë traditën e moçme me punime mjaft cilësore, të cilat pëlqehen shumë për kolorin dhe mjeshtrinë e thurjes e qendisjeve të veshjeve e paisjeve tradicionale.